

PROMOVIMI I BARAZISË DHE RESPEKTIT: NJË BASHKËPUNIM MES BESIMEVE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Dhuna në familje është një problem i rëndë në shoqërinë tonë që ndikon te shumë gra dhe fëmijë.

Dhunë në familje është çdo sjellje që është abuzive nga ana fizike, seksuale, emocionale ose psikologjike ose që kërcënon apo kontrollon një partner ose anëtar familjeje. Këto sjellje përdoren për të dominuar mbi një anëtar familjeje dhe për ta frikësuar atë.

Dhunën kundër grave mund ta ndalojmë përpara se të ndodhë. Kjo gjë njihet si parandalim. Fillimisht duhet të kuptojmë se pse ndodh dhuna kundër grave. Studimet na tregojnë se dhuna kundër grave shkaktohet nga:

***Pabarazia mes burrave dhe grave:** Zakonisht, burrat kanë më shumë pushtet dhe influencë në jetën publike krahasuar me gratë. Për shembull, është më e zakonshme që burrat të mbajnë pozicione drejtuese në politikë, biznes dhe fe. Ata mund të kenë gjithashtu më shumë pushtet dhe influencë edhe në jetën private, siç janë marrëdhëniet e tyre dhe në shtëpi.

***Pritshmëritë e roleve të burrave dhe grave:** Ka pritshmëri të caktuara rreth roleve që kanë burrat dhe gratë në shoqëri. Këto pritshmëri shpesh i shohin gratë si pasive dhe si përgjegjëse për punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët, ndërsa shpesh burrat shihen si të fortë dhe përgjegjës për detyra të tjera (si p.sh. kopshtari).

***Qëndrimet dhe sjelljet që mbështesin dhunën:** Ka disa qëndrime në shoqërinë tonë që mbështesin dhunën e burrave kundër grave dhe që nuk e konsiderojnë atë si të papranueshme.

Për të parandaluar dhunën kundër grave, ne duhet t'i japim përgjigje pabarazisë gjinore.

Komunitetet fetare mund të luajnë një rol në promovimin e barazisë dhe respektit si shembuj të fuqishëm që mund t'i japin udhëzime komunitetit.



Ky propozim është zhvilluar si pjesë e projektit "CHALLENGE Family Violence", një partneritet mes Qytetit të Casey, Bashkisë së Cardinia Shire, Qytetit të Greater Dandenong dhe Monash Health. Ky projekt është financuar sipas programit të granteve "Reducing Violence against Women and their Children" (Reduktimi i dhunës kundër grave dhe fëmijëve të tyre), pjesë e "Community Crime Prevention Program – local solutions for local crime prevention issues" (Programi për Parandalimin e Krimit në Komunitet - zgjidhjet lokale për çështjet e parandalimit të krimit lokal) nga Qeveria e Viktorias.



Ky propozim mbështetet nga Rrjeti Ndërfetar i Qytetit të Greater Dandenong.



SI MUND TË PROMOVOJNË BARAZINË DHE RESPEKTIN DREJTUESIT SHPIRTËRORË DHE FETARË?

1. KRIJONI NDËRGJEGJËSIM

Krijimi i ndërgjegjësimit rreth dhunës në familje, dhunës kundër grave dhe shkaqeve të saj është i rëndësishëm sepse është një çështje që shpesh për të cilën nuk flitet në publik. Kjo mund të bëhet duke publikuar informacione rreth kësaj çështjeje në buletinet informative të komunitetit, duke vendosur afishe rreth vendit të adhurimit ose duke shpërndarë fletëpalosje.



2. ZHVILLONI DISKUTIME NË KOMUNITET

Drejtuesit shpirtërorë dhe fetarë mund të hapin biseda rreth barazisë dhe respektit në rolet e grave dhe burrave dhe në marrëdhëniet që ata kanë me njëri-tjetrin. Kjo mund të bëhet gjatë një mesazhi apo fjalimi në komunitet ose në një mënyrë më jozyrtare me grupe më të vogla të anëtarëve të komunitetit. Sigurohuni që të përfshini në këto diskutime gratë dhe burrat.




3. ANGAZH OHUNI NË NDËRGJEGJËSIMIN E KOMUNITETIT

Ekzistojnë shumë aktivitete komunitesh që synojnë promovimin e respektit mes burrave dhe grave siç është "White Ribbon Day" (Dita e fjongos së bardhë) në 25 Nëntor dhe "Week Without Violence" (Java pa dhunë) në Tetor. Komuniteti juaj mund të marrë pjesë në to ose të zhvillojë evenimentet e veta.



4. VEPRONI NË KOMUNITET

Gjithkush mund të veprojë brenda komuniteteve fetare për të ndryshuar praktikën e tyre të përditshme duke hartuar një plan në komunitet për barazinë mes burrave dhe grave, duke i trajnuar drejtuesit e rinj rreth respektit në marrëdhënie dhe edukimit të të rinjve.



5. NDËRTONI PARTNERITETE DHE DILNI NË MBROJTJE TË NDRYSHIMIT

Ndërtimi i partneriteteve me komunitetet e tjera fetare dhe rrjetet ndërfetare është një mënyrë e dobishme për të shkëmbyer idetë rreth mënyrës së parandalimit të dhunës në familje. Komunitetet dhe rrjetet gjithashtu mund të takohen së bashku për të mbrojtur praktikën e ndryshimit për të pasur më shumë ndikim në grupimet e tyre fetare.

